Asambleja
01.Nr.I
Deçan,dt.31.01.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.31.01.2019.
Në mbledhje ishin prezent:25 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, OSBE, KFOR, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019,
3. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit,
6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për emërimin e rrugëve dhe marrja e vendimit për emërim të rrugëve,
8. Marrja e vendimit për miratimin e listës së vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit,
9. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale,
10. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e I-rë të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 25 asambleist (mungon Fekri Qufaj dhe njofton se Kastriot Lokaj ka dhënë dorëheqje por ende nuk jane kryer procedurat per zevendesimin e tij).
Kryesuesi- e prezentoj rendin e punës të propozuar me ftesë.
Milazim Mushkolaj- ka propozuar që të hyn në rend pune –Formimi i një komisioni për verifikim të normave dhe të punës së mësimdhënësve.
Mon Selmonaj- ka pasë vërejtje rreth rendit të punës dhe ka kërkuar sqarim pse nuk ka dalë në rend dite Plani i arsimit i cili i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit, Raporti i auditorit të jashtëm për vitin 2017, i cili është dashtë të na vjen vitin e kaluar dhe raporti 9 mujor financiar, mendoj se nuk është përmbushë plani i punës së Kuvendit për vitin 2018 ka thënë ai, prandaj kërkoj përgjigje për këto.
Kryesuesi- ka thënë se Plani i arsimit do të vjen në Kuvend kur të jetë i gatshëm, pastaj e qiti në votim propozimin e Milazim Mushkolaj, për formimin e Komisionit .
Fatmir Kurmehaj-ka thënë se jemi për formimin e një komisioni të tillë nëse mund të marrim vendim , mirëpo vetëm sa për një raport nuk është e nevojshme dhe mund të vazhdojmë sipas rendit të ditës.

Drejtori i Buxhetit- sqaron se janë disa vite që ne e ndihmojmë arsimin nga buxheti komunal, mirëpo kish qenë mirë që në rast të shqyrtimit të jetë prezent edhe drejtori i arsimit për të dhënë sqarime.
Kryesuesi- edhe një herë e qiti në votim propozimin e Milazim Mushkolaj - Formimi i një komisioni për verifikim të normave dhe të punës së mësimdhënësve.
Antarët e asamblesë me 15 vota për dhe 8 vota kundër vendosën që kjo pikë të shqyrtohet.
Kryesuesi e qiti ne votim rendin e punes ashtu si ka ardhe, antarët e asamblesë e miratuan kete rend pune.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.
Kryesuesi- e prezentoj pikën pastaj e hapi debatin rreth saj.
Fatmir Kurmehaj-vlerëson se është një plan orientues , si plan e përkrahim, kërkojmë nga ekzekutivi të jenë ma koshient në zbatimin e këtij plani, Moni i ceku në fillim temat e pa shqyrtuara nga viti kaluar, Raportin e kryetarit, raportin e auditorit të jashtëm dhe raportin 9 mujor, përndryshe si plan e përkrahim.
Kryesuesi- e qiti në votim dhe tha se pa prezencën e ekzekutivit nuk do ti trajtojmë temat nga fushëveprimtaria e tyre.Aprovohet njëzëri plani i punës së Kuvendit pa ndryshime.
IV. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2018.
Kryesuesi e ka prezentu kete pike dhe e ka hape debatin rreth saj, mirëpo nuk kishte propozime per ndryshim, ne vazhdim kryesuesi e qiti ne votim si te tille, antaret e asamblese e miratuan pa ndryshime.
IV. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve,
Kryesuesi- e ka prezentu piken, pastaj ka sqaruar se janë zhvilluar te gjitha procedurat e shqyrtimit te këtij propozim ndryshimi te rregullores, ne vazhdim e ka ftuar kryetaren e komisionit për të dhënë sqarime.
Lirije Zukaj, kryesuese e komisionit sqaron se komisioni propozon edhe ndryshim te të gjitha nenet ku thuhet Vendim i Komisionit vlerësues duhet të zëvendësohet me fjalë "Rekomandim "i komisionit vlerësues, dhe te neni 8. komisioni për shqyrtimin e kërkesave duhet të formohet nga Kryetari i Komunës prej 3-5 anëtarë të ekzekutivit.
Rifat Stojkaj- thot qe meqenëse nuk kemi arritur ti ndajmë si kategori studentët kërkoj që të gjindet forma për ndarjen e bursave, përndryshe e përshëndes komisionin për punën e bërë sepse i ka përfshi të gjitha kategoritë në rregullore.
Fatmir Kurmehaj- subvencionet janë kompetencë ekskluzive e kryetarit, kërkoj që kur bëhet fjalë te bursat e studentëve të hiqen nga rregullorja dhe të planifikohen me buxhet, si pozicion i veçantë.
Rifat Stojkaj- thot se kontributi jonë nuk ka me ngecë në kë drejtim por këtë vit të mbetet kështu.
Albesë Cacaj-thot se qe 5 vite që jam në asamble nuk kemi mundur ti përkrahim studentët prandaj kërkoj që me rishikim të buxhetit të ndahen bursat.
Valdet Nuraj-thot se për studentë kemi folur mjaft por konkret nuk kemi bërë asgjë, mirëpo në këtë shumë sa kemi për subvencione vështirë që mund të ndajmë mjetet e nevojshme për subvencionim të studentëve.
Florim Mataj-studentët me notë 10 e marrin bursën e univerzitetit, unë nuk jam kundër me ju ndihmu të gjithëve por duhet ti shofim mundësitë financiare.
Drejtori i buxhetit- thot qe nëse ju si asamblista vendosni sot te ndani bursa per studentë duhet të caktoni edhe shumën sa mendoni të hiqen nga shuma totale, ose ju sot mi miratu ne parim e pastaj mu marre vesh me ekzekutivin sa do te jete shuma e bursave.
Besnik Hulaj-thot se ne vetëm pi qesim ne letra kurse kur po vjen puna me kurrgjë nuk po mund ti ndihmojmë.

Mon Selmonaj- thot se ma mirë është përmes buxhetit me i planifiku sepse në rregullore nuk po realizohen.
Albana Avdiu- thot se e përkrahi propozimin per ndarjen e bursave, por tani propozoj që të kalon në parim sepse i kemi edhe të hyrat e bartura mirëpo ka edhe rrugë tjera.

Kryesuesi- thot te miratohet ne parim sipas rekomandimit të KPF-se si dhe me propozimin per ndryshime te kryesueses së komisionit.

Fatmir Kurmehaj- kërkon në emër të LDK-së që të kalon kjo formë që është, kurse bursat të ndahen me rishikim të buxhetit.

Natyra Kuçi- edhe në KPF kemi kërkuar që të caktohet shuma në mënyrë që me ditë se sa studenta mund të përfitojnë, idea është që nëse ne sot themi se kanë mu nda bursa ajo me ndodhë.

Rifat Stojkaj-thot se ka qenë vullneti jonë që bursat me qenë kategori buxhetore por e vetmja mënyrë për momentin është kështu prandaj kërkoj që ta qesim në votim.

Kestrim Avdimetaj- thot se bursat e studentëve nuk ka mundësi të planifikohen me buxhet por vetëm kështu në rregullore të subvencioneve, por prioriteti me qenë arsimi dhe përveq Univenrsitetit të Prishtinës univerzitetet tjera nuk kanë mundësi të ndajnë bursa, por sidoqoftë kërkon që të gjindet forma dhe të përkrahen kjo kategori.

Kryesuesi- tha se e trajtuam mjaft këtë temë dhe e qiti në votim rekomandimin e KPF-së me propozimin e Lirije Zukaj sot këtu në mbledhje.

Mon Selmonaj- thot se është mirë që të harmonizohen qëndrimet.

Kestrim Avdimetaj-të votohet në parim por të mbajmë prap takim e ti harmonizojmë gjanat.

Fatmir Kurmehaj- thot se është turp që si Komunë qe 15 vjet nuk kemi nda bursa dhe, edhe një herë kërkon që të specifikohet shuma për bursa.

Valdet Nuraj- kërkon që të shtjerret krejt debati.

Mustafë Selmanaj-thot se të jemi për ndarjen e bursave dhe sa të na jepet mundësia po i ndajmë.

Milazim Mushkolaj- thot mi miratu në parim ashtu si ishte.

Kryesuesi- e qiti në votim rekomandimin e KPF-së me propozimin e Lirije Zukaj sot këtu në mbledhje.

Antarët e Kuvendit e miratuan me shumic votash, rezultati i votimit ishte 19 për, 4 kundër, 1 apstenim.

V. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit, pastaj për sqarime e ka ftuar drejtoin e drejtorisë për MSH dhe SHP.
Drejtori i drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike- ka shtuar se pas zhvillimit të gjitha procedurave të cekura, tani rregullorja është një dokument i rregullt.
Fatmir Kurmehaj-kërkon që te shuma e pagesave , katagoria e ekonomive familjare, çmimi 4.56 € me qenë pak më i ulët.
Drejtori-sqaron se te tarifat eshte bere analizë dhe kemi shkuar me çmimin ma te ulet se Peja dhe Gjakova.
Mehmet Osaj-thot se pajtohem me Fatmirin sa i përket çmimit, sepse ky çmim është ma i lartë se operatori privat, prandaj propozoj që të ulet kjo tarifë.
Drejtori- sqaron se janë mbajte debatet publike dhe nga qytetarët nuk ka qenë kërkesë për ulje të çmimit por kanë kërkuar vetëm shërbime cilësore, prandaj mendoj se duhet me kalu kështu.
Rifat Stojkaj-falënderon drejtorin e Drejtoris për MSH dhe SHP për punën e jashtëzakonshme që ka bërë bashkë me ekipin e vet dhe u kuptua se nga debatet publike qytetarët kanë kërkuar vetëm shërbim të mirë dhe efikas ndërsa me tarifa janë pajtuar.

Mon Selmonaj- kërkon sqarim te neni 14-Komisioni monitorues sepse kemi shum paqartësi ka thënë ai, prandaj propozoj ka thënë ai që ky nen të fshihet dhe veprimtarinë e këtij komisioni ta kryejnë kryetarët e Këshillave të fshatrave.
Drejtori- sqaron se komisioni qe formohet sipas nenit 14 eshte një epik i njerëzve vullnet mirë që punojnë por nëse është vullneti i kryetarit mund ta bëjmë një pagesë simbolike..
Shkelezen Hadergjonaj-pyet, për sa kohë do të shtrihet veprimtaria e Ndërmarrjes Higjiena për pastrim të mbeturinave në krejt territorin e komunës dhe kërkon që punëtorët e ndërmarrjes të paisen me uniformë, si dhe pyet çka do të bëhet me kompanitë private që operojnë në këtë lëmi.
Drejtori –sqaron se për momentin kompania e ka shtrirjen në 43% të territorit të komunës, dhe deri në fund të 2019-es kompania do të shtrinë veprimtarinë në tërë territorin e komunës, me uniforma do te paisen punëtorë deri në muajin mars ose prill, operatori privat ka qenë gjysmë ilegal dhe në momentin që kompania e shtrinë veprimtarinë ai faktikisht nuk ka mundësi të operimit.
Valdet Nuraj- pyet, a i kryejnë obligimet e pagesës qytetarët dhe si ka shkuar mbulimi i territorit me përqindje.
Drejtori- sqaron se fillimisht është mbuluar tereni me 23%, tarifa e re do të aplikohet pas miratimit të rregullores.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera kryesuesi e qiti në votim projekt rregulloren pa ndryshime, antarët e Kuvendit e miratojnë ate me shumic votash rrezultati i votimit ishte 20 për, 2 kundër (PDK).
VI. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë.
Kryesuesi- e prezentoj propozimin e kryetarit dhe dha sqarime rreth tij, antarët e kuvendit njëzëri e miratuan propozimin e Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë, ku do të fitojnë familjet me nevojë.
VII. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për emërimin e rrugëve dhe marrja e vendimit për emërim të rrugëve.
Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon kryesueses se komisionit.
Ermblina Tahiraj, kryesuees e Komisionit- fillimisht ka bërë vërejtje për tabelat e rrugëve të vendosura më herët të cilat janë dëmtuar, pastaj ka sqaruar rekomandimin e komisionit për emrim të rrugëve.
Kryesuesi- e hapi debatin rreth temës në fjalë.
Pas debatit të zhvilluar në kuvend, ishte disponimi i antarëve të kuvendit që vetëm pika nr.4 e rekomandimit të kalon ndërsa emrimet tjera të shtyhen , në fund Kuvendi vendosi për emrimin e propozimit nga pika nr.4 e Rekomandimit të komisionit, ndërsa pikat tjera shtyhen, sipas këtij vendimi në fshatin Gramaqel, rruga "Jagozi" riemërohet "Shpend Rexhaj".Kuvendi njëzëri vendosi për këtë pikë.
VIII. Marrja e vendimit për miratimin e listës së vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit.
Kryesuesi- e prezenton piken, pastaj fjalën ia kalon Kryetarit të Komunës për të dhënë sqarime.
Kryetari i Komunës- ka dhënë sqarime të mjaftueshme për të pranishmit.
Mon Selmonaj-propozon që kësaj liste ti shtohen edhe hapsirat publike të fshatrave Rastavicë dhe Irzniq.
Kryetari ka thënë se nuk pajtohet me këtë propozim me arsyetimin se nuk do të jemi ne më autoriteti e tyre.

Kryesuesi- e qiti në votim, antarët e kuvendit njëzëri aprovuan listën e vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit, sipas shënimeve në vijim:

Nr.	Vendbanimi	Objekti	Kordinatat X	Kordinanat Y	Lartësia mbidetare
1	Llukë e Ulët	Gleni I Llukës	-	-	-
2	Kodrali	Trungu i Blirit	-	-	-
3	Strellc I Ulët	Trungu I Blirit	0443593	4714077	576
4	Strellc I Epërm	Trungu I Blirit	0441801	4714155	653
5	Deçan	Burimi I ujit mineral	0439827	4710943	644
6	Deçan	Trungu I Blirit	0441261	4709725	633
7	Maznik	Trungu I dushkut	0453817	4710299	434
8	Dashinoc	Trungu i dushkut	0450452	4709613	480
9	Ratishë e Ulët	Trungi I mrizit(bungut)	-	-	-
10	Ratishë e Epërme	Trungi I dushkut	0448477	4728154	507
11	Ratishë e Epërme	Komkleksi I trungjeve	0448136	4708422	522
12	Shaptej	Kompleksi I trungjeve dushkut	0449262	4705079	455
13	Gramaqel	Kompleksi I trungjeve-Varrezat e Jagozit	-	-	-
14	Gllogjan	Trungu I dushkut	0447816	4706272	519
15	Carrabreg I Eperm	Trungu I dushkut	0441720	4708619	621
16	Drenoc	Trungjet e blirit dhe Trungu I Pishes	0441783	4707251	606
17	Rastavicë	Trungu I dushkut	0444732	4704069	523
18	Rastavicë	Trungu I Blirit	0444791	4704979	520

IX. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Kryesuesi- pas prezentimit të pikës sqaron se sipas rregullores ky komision duhet të formohet prej 7 antarëve 4 prej tyre duhet të jenë nga asambleja, 1 ekzekutivi, 1-perfaqësues i Këshillave lokale, 1- OJQ.

Kryetari- sqaron se të gjithë Këshillat Lokale të fshatrave kanë qenë mjaft korrekt, por kurr nuk janë përkrahur financiarisht asgja sepse nuk kanë lejuar procedurat ligjore.

Në vazhdim formohet Komisioni për zgjedhjen e Këshillave Lokale, në këtë përbërje:Albana Avdiu AAK, Shkelzen Hadergjonaj AAK, Uran Tolaj LDK, Mon Selmonaj PDK, ndërsa nga Ekzkeutivi Jashar Dobraj, nga OJQ Adem Lushaj, nga Këshillat Lokale Beqir Kuçi.

Vendimi merret njëzëri

Takimin e parë të komisionit e thirre Kryesuesi i kuvendit në të cilin takim Komisioni do ta zgjedhë kryesuesin nga radhët e veta.

X. Formimi i komisionit për verifikim të normave dhe të punës së mësimdhënësve, i cili ka detyrë për vlerësimin e normativës së mësimdhënësve në raportin sa janë mësues-nxënës.

Bekim Vishaj, drejtor komunal i Arsimit- sqaron se në krejt Kosovë qëndron problemi i normës së mësuesve sipas formulës së numrit të nxënësve, për të cilin edhe ndahet buxheti.

Fatmir Kurmehaj- kërkon që për këtë pikë duhet ti japim një afat kohorë drejtorit të arsimit i cili duhet të na sjellë një raport e pastaj të vazhdojmë.

Erdogan Dautaj- kërkon që të formohet komisioni e pastaj shofim.

Drejtopri i arsimit- kërkon afat kohor për ta sjellë raportin.

Rifat Sojkaj- thot se e përkrahim idenë e drejtorit për përgaditjen e raportit për një kohë të arsyeshme reale sa mundet ai mi përgaditë.

Mehmet Osaj- thot të formohet urgjent komisioni për këtë çështje.

Në vazhdim Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e Drejtorit të arsimit që sot mos të formohet komisioni por ai sipas mundësive më të mundëshme të përgaditë raport për asamble ku do të qartësohen normat e mësuesve , numri i nxënësve dhe çështje tjera me rëndësi për arsimin komunal.
Propozimi miratohet me shumic votash, 18- për propozimin e drejtorit, 4 kundër, dhe sipas këtij rezultati nuk formohet komision por pritet raporti i drejtorit.
XI.Të ndryshme.
Valdet Nuraj- ka kërkuar sqarim nga Kryetari për projektin e Ujësjellësit të Strellcit- a ka informta deri ku kan shku punimet, shkolla në Strellc të Epërm ku vijojnë mësimin nxënësat prej fshatit Lëbushë dhe aty fare nuk figuron tabela "kujdes shkolla", ai ka ngritë edhe qështjen e kushteve të Shërbimit të Ofiqarisë në fshatin Strellc- pa pastrues dhe pa orman për vendosjen e librave të gjendjes civile.Valdeti pyet edhe në Strellc të Ulët a është kry objekti i shkollës për të cilën përgjigjet kryetari se është kry.
Kryetari- sqaron për projektin e ujësjellësit të Strellcit për të cilin thot se aty po kryhen punimet dhe 30% e projektit është kry, nërsa njerëzit kompetent dhe mbikëqyrës të atij projekti janë Hidrodrini, ndërsa te shenjëzimet te shkolla në Strellc të Epërm, Kryetari sqaron se kjo bëhet sipas procedurës, plus aty janë të rregulluara edhe nënkalimet të cilat duhet të shfrytëzohen.
Basnik Hulaj- ka ngritë qështjen e shtrimit të rrugëve jo sipas standarteve në fshatit Prejlep.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • KOMUNA E DEÇANIT • MUNICIPALITY OF DEÇANI • Komuna/Kuvendi • Kuvendi/Assembly • Komunalna/Skupština/Assembly

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.II
Deçan,dt.28.02.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.28.02.2019.
Në mbledhje ishin prezent: anëtarët e asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, OSBE, KFOR, mediat, përfaqësues te klubeve sportive.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP dhe marrja e Vendimit për caktimin e lokacionit për Deponi inerte,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP dhe marrja e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena",
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal të veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit ,
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm,
7. Marrja e vendimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2018 në vitin 2019,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 26 asambleist .
Kryesuesi- e prezentoj rendin e punës të propozuar me ftesë.
Mon Selmonaj- ka kërkuar që të futet në rend pune Shqyrtimi i Kërkesës së fshatit Rastavicë rreth projektit të autostradës që ju kalon në pronat e tyre.
Kryetari i Komunës- thot se kërkesa ka ardhë edhe në zyrën time, ne mund të bëjmë debat këtu sa të doni, por nuk mund të ndryshojmë diçka në atë drejtim me debatin që do të zhvillohet këtu por sot e kam një takim me kompaninë projektuese dhe propozoj që ta caktoj një takim ku do të marrin pjesë :Përfaqësuesit e Ministrisë, Kompania projketuese, përfaqësuesit e fshatrave, përfaqësuesit e Asamblesë dhe Ekzekutivi.
Mon Selmonaj- pajtohet me propozimin e Kryetarit.
Fekri Qufaj-kërkon që në atë takim të marrin pjesë edhe qytetarët e Prejlepit, për të cilën merr përgjigje pozitive nga Kryetari.
Kryesuesi e qiti ne votim rendin e punes te propozuar me ftesë, antarët e asamblesë e miratuan ate.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Florim Mataj-thot se fjala e tij e plotë nuk i është përfshi në procesverbal prandaj e dorëzon me shkrim diskutimin e tij, që do të përshkruhet në vazhdim i plotë ashtu siq është në dorëshkrim:"1.I nderuari Fatmir dhe Mon ju po i vendosni ne komisione anëtarët e juaj dhe komisionet po e kryejnë punën e vet pasi po vijnë propozimet në kuvend për tu votuar ju po kundërshtoni edhe pse të gjitha propozimet qe po vijnë nga anëtarët e juaj ne komision po shqyrtohen, kure janë propozime ne të mirë të qytetarëve, edhe po aprovohen, kemi punuar ne komisionin për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të Komunës dhe kure e kemi pru per votim keni votuar kundër.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit.
Andaj unë propozoj që rregullorja për shpërndarjen e subvencioneve të hidhet në votim, demokraci jemi dhe vendosin votat. Dhe mose paragjykoni se nuk do ndahen bursa per studenta, se kan me u nda bursat, oshte zotim i Kryetarit dhe i yni.
Është kërkuar që kategoria e ekonomive familjare, të ulet çmimi i vendosur për ekonomit familjare në vlerën monetare:4.56 €, është thënë se është çmim i lartë, sepse operatoret ekonomik privat janë me te lire.
Unë e kame sqaru se kompanitë private i bartin mbetirunat me çmim me te ulet por dy her në muaj, ndërsa kompania Higjiena e bënë bartjen e mbeturinave 4 here në muaj, andaj kam kërku që çmimi mose te ulet pore të rritet shërbimi"
Procesverbali miratohet njëzëri me plotësimin e Florim Mataj.
II. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP dhe marrja e Vendimit për caktimin e lokacionit për Deponi inerte.
Kryesuesi- e prezentoj pikën pastaj e ftoj drejtorin e Drejtorisë për MSH dhe SHP për të dhënë sqarime rreth saj.
Drejtori-sqaron se lokacioni i propozuar është parë si vendi më i favorshëm , ai do të jetë për periudhën dy vjeçare, e pastaj do të rishikohet.
Valdet Nuraj- thot se propozimi sipas dokumentacionit është për 56.000 m^2, për momentin aty nuk ka kushte për hedhje të mbeturinave, propozoj që të gjindet një lokacion tjetër më i përshtatshëm, aty është mirë që të rrafshohet, të thuret dhe të ruhet.
Drejtori-thot se menjëherë pas aprovimit, mbledhjen tjetër do të vjen rregullorja për menaxhim të deponisë dhe do të rregullohet çdo gja.
Valdet Nuraj-fillimisht duhet të rregullohet shtrati i lumit aty e pastaj me fillu me gjujtë mbeturina.
Drejtori-aty ka me pasë vetëm mbeturina inerte dhe do të menaxhohet mirë.
Rifat Stojkaj-thot se është duke u punuar në këtë drejtim dhe kërkoj që ky lokacion të menagjohet nga kompania Higjiena per dy vite.
Drejtori- thot se rregullorja do ta përcakton qartë menagjimin.
Fatmir Kurmehaj- thot se kisha pase deshirë që pikat e rendit të ditës të ishin renditë ndryshe dhe fillimisht eshte dashtë të debatohet rreth raportit të auditorit të jashtëm, deponia aty ku është propozuar që të jetë nuk na bënë nderë , aty kalon lumi Behovc i cili gjatë kohës së shirave del nga shtrati dhe din të jetë shum i rrezikshëm, kërkoj që të na vjen lista e pronave komunale dhe ne të shofim ku mund ta gjejmë një lokacion tjetër më të favorshëm, propozoj që aty të rrafshohet të mirëmbahet dhe ti ipet dikujt me qera, mirëpo ajo pjesë me vendim të këtij kuvendi është dedikuar për treg të kafshëve një herë.
Kryetari-thot se asambleja dhe çdo qytetar ka të drejtë të qfaqë shqetësimin e vet, ne kemi për detyrë të tregojmë për angazhimet tona për deponi inerte të cilat nuk e ndotin ambientin, ajo pjesë ka qenë e dedikuar për treg regjional të kafshëve por nuk është realizuar si projekt.
Kestrim Avdimetaj- thot me qenëse jam banorë i asaj treve pajtohem me Fatmirin dhe Valdetin krejte qka thanë prandaj mendoj se do të ishte mirë që të gjindet një zgjidhje tjetër me lokacion tjetër.
Drejtori- thot se një vendim të tillë Asambleja e ka marrë edhe në vitin 2005 për të njëjtin lokacion per afat një vjeçare.
Rifat Stojkaj- thot se jemi këtu për të mirën e qytetarëve dhe lokacioni i propozuar shkon në të mirën e të gjithëve dhe kërkon nga Kryesuesi që të qitet në votim.
Krysuesi- e qiti në votim, antarët e Kuvendit e miratuan me shumicë votash, rrezultati i votimit ishte 17 për (AAK), 5 kundër (LDK), 4 apstenim(3 nga PDK dhe 1 PSD).

III. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP dhe marrja e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena",
Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj e hapi debatin.
Mehmet Osaj- ka thënë se propozimi për caktimin e këtij lokacioni është një hap i ngutshëm dhe vendimet e shpejta po na kushtojnë, kish qenë mirë që të gjindet një vend tjetër më i favorshëm dhe unë jam kundër propozimit që ajo pjesë të caktohet si lokacion për ndërtimin e objektit të kompanisë Higjiena.
Rifat Stojkaj- thot se është e specifikuar shum mirë mirëpo është propozim i AAK-së që nëse ka mundësi mos të ndërtohet në Stadion por aty pranë.
Drejtori- sqaron se bjen në krahun e poshtëm nën stadion.
Valdet Nuraj- propozon që të caktohet në Strellc bash në lokacionin e deponisë sepse ka hapsirë mjaft.
Fatmir Kurmehaj- thot se ndërtimi i objektit të kompansië Higjena është e domosdoshme, nëse ka mundësi të gjindet një hapsirë tjetër si psh aty ku tha Valdeti e jo aty në zonë të turizmit.
Drejtori- thot se janë shiquar mundësitë por ai është vendi më i favorshëm.
Florim Mataj-thot se po flasim për një kompani që ka fillu me dhanë rezultate, vendi ku propozohet të ndërtohet objekti është shum okej sepse është për një kohë të gjatë prandaj e përkrahi këtë propozim.
Kryesuesi- e qiti në votim kërkesën e Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena", antarët e kuvendit e miratuan me shumic votash, 17 për, 4 abstenime, 5 kundër.
IV. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal të veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.
Drejtori Drejtorisë për MSH dhe SHP sqaron se është obligim ligjorë dhe është e domosdoshme sepse përfitojmë grante në këtë drejtim.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, kryesuesi e qiti në votim, antarët e kuvendit e miratuan njëzëri ate.
V. Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit .
Drejtori Drejtorisë për MSH dhe SHP sqaron se në vitin 2010 është bërë azhurimi i fundit i këtij plani, të dhënat e përdorura këtu janë marrë nga të gjithë akterët që ndërlidhen me këtë plan.
Milazim Mushkolaj-thot se materiali na ka ardhë në CD dhe nuk kam pasë mundësi ta hapi fare.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera kryesuesi e qiti ne votim , anëtarët e kuvendit e miratuan ate me 25 vota per, 11 kunder.
VI.Shqyrtimi i raportit të auditorit të jashtëm.
Mon Selmonaj- ka thënë se raporti sipas auditorit të jashtë është cilësuar si opinion i pamodikfikuar me theksim të qështjes, sipas raportit, të gjeturat e auditorit janë : pronat komunale të paqregjistruara(shkolla e Junikut), borgjet-komuna nuk ka planifikuar buxhet shtesë për larjen e borgjeve.
Mehmet osaj- i drejtohet Monit se po lexon krejt atë çka ka thene auditori e qe eshte e shkruar dhe te gjithë ne mund ta lexojmë ashtu.
Mon Selmonaj- ka vërejtje në menagjim të mbledhjes nga kryesuesi duke u ndërlidhur këtu me fjalën e Mehmet Osaj.
Pastaj vazhdon diskutimin te investimet kapitale të parealizuara tërsisht sipas planifikimit-ekzekutim i ulët te investimet kapitale shkak menagjimi jo i mirë, Qështjet e prokurimi, te burimet njerëzore ka shkelje te afatet dhe llogaritje e gabuar e përvojës së punës, e gjetur ne drejtorinë e Arsimit kontrata për dru, subvencionet nuk janë menaxhu mire, te kapitalet vonesa e realizimit te kontratës ne salle te sporteve , renovimi ne shtëpinë e komuniteteve, Keqklasifikim te shpenzimeve (a, b, c, automjeti i QKMF-se, automjeti i shtëpisë se komuniteteve, kërkohet nga kryetari kontrolle shtese , mungesa e kontrollit ne menaxhim te automjeteve zyrtare, prona komunale shfrytëzohet pa kontrate, pastaj ka prezentu shifrat krahasuese 2016/2017,

Rekomandime- performancë ma të mirë në inkasim të hyrave, Verifikimi i pronave mangësi në klasifikim, ne vazhdim ai ka thënë se ka edhe terme ekonomike te panjohura ne raport.
Natyra Kuçi-thot se është e pa pranuseshme fakti qe qohet një person dhe e dekoncrenton diskutantin.
Rifat Stojkaj- thot se nuk e përkrahim gjuhen e përdorur këtu kundër njeri tjetrit, pastaj vazhdon se raporti eshte i mandatit para neve, mirëpo ne kërkojmë nga Kryetari qe mundësisht te behet evitimi i te gjitha te gjeturave te auditorit.
Kryetari- sugjerimet dhe te gjeturat e auditorit duhet te shkojnë ne funksion te evitimit të tyre dhe përmbushje te rekomandimeve, ne e kemi bërë një strategji të komunës dhe duhet te kemi kontrolle shtesë, mirëpo megjithatë ne kemi përmirësim duke krahasuar ne nje vit me pare dhe shpresojmë se kete vit do te jemi edhe me mire, Komuna do ti merr per baze te gjeturat e auditorit dhe verejtjet tuaja per nje pune me te mire.
Fatmir Kurmehaj- eshte mire qe ka ardhe si raport per shqyrtim këtu ne kuvend, pastaj pyet kryetarin se cilët hapa do te ndërmerr per evitim te gjeturave të auditorit, mirëpo shumica e te gjeturave janë te pronat komunale, menaxhimi i buxhetit, inkurajoj kryetarin per përmbushje te kontratave dhe mos te hapen procedura pa mjete buxhetore ka thene ai.
Kryesuesi- thot se i dëgjuam diksutimet rreth te gjeturave te auditprit mirëpo edhe fjalën e kryetarit dhe premtimet e tij per nje vit me te suksesshëm, prandaj e mbyllim debatin rreth kësaj teme duke i rekomanduar ekzekutivit qe te kemi sa ma pak te gjetura nga auditori.
VII.Të hyrat e bartura.
Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa sqaron se të hyrat e bartura nga viti 2018 në vitin 2019 janë në shumën prej **355,556.73 €,** dhe sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ nuk mund ti lëvizim mjetet e mbetura nga kategoritë që kanë qenë në 2018.
Albesa Cacaj- kërkon që të specifikohen rrugët që planifikohen të rregullohen me këto mjete.
Fatmir Kurmehaj dhe besnik Hulaj pajtohen me kërkesën e Albesës.
Drejtori i buxhetit- thot se ato janë të planifikuara në Llotin nr.1 dhe Llotin nr.2. dhe mund te jau sjelli per verifikim.
Meqenëse nuk kishte diksutime tjera Kryesuesi e qiti në votim, antarët e Kuvendit e miratuan me shumic votash, rezultati i votimit ishte 15 për(AAK), 4 kunder(grupi PDK dhe Fatmir Kurmehaj), 3 apstenim(Uran Tolaj, Rejhana Tolaj dhe Netyra Kuçi).
XI.Të ndryshme.
1.Kërkesa e KF Deçani.
Drejtori i buxhetit sqaron se i kemi 10,000 € për sport në përgjithësi.
Milazim Mushkolaj- ka kërkuar që krahas KF Deçni të përkrahet edhe KF Besa Irzniq sepse i kemi strukturat udhëhesëse të klubit të formuara plus bëjmë gara në të njëjtin rang të garave.
Albana Lokaj-nuk jam pe rate qe te ndihmohet vetëm nje klub, ne e kemi edhe klubin e Hendbollit femrat qe ju kemi premtu ne kete asamble se do ti ndihmojmë poashtu edhe klubin e hendbollit meshkujt, prandaj kërkoj qe te gjitheve me ju ndihmu nga pak sa ti kemi mmundesite.
Shkelzen Hadergjonaj-propozon qe dy klubet e futbollit te bashkohen ne nje dhe ti përkrahim si nje klub ma te fuqishëm.
Rifat Stojkaj- kemi pase edhe kërkesa tjera , kërkojmë te gjindet nje mes per ti perkrahe, propozoj qe ne kete mbledhje te perkrahet KF Deçani e pastaj edhe klubet tjera pas nje takimi te përbashkët qe do te mbajmë me kryetarin .
Natyra Kuçi thot pse nuk ka ardhe kërkesa financiare e klubit dhe nëse financohet vetëm nje klub ne duhet te shofim sa janë te arsyeshme edhe kërkesat e klubeve tjera, propozoj qe ne nje seance te ardhshme me ardhe te gjitha kërkesat e sportit dhe ne me shiqu sa mund ti ndihmojmë.
Valdet Nuraj-thot se ma shum duhet mi ndihmu KF Deçani, sepse eshte klub i qytetit, mirëpo kërkon që të bëhet çdo gje dhe të ndihmohet edhe KF Besa.
Drejtori i buxhetit- thot se ne i kemi 10.000 € dhe fillimisht propozoj qe te ndahen per KF Deçani qe ti fillon garat, e pastaj te mblidhemi dhe te diskutojmë sa mund ti përkrahim te gjitha klubet e sportit, ai propozon qe te behet nje komision gjithëpërfshirës dhe ta bëjmë nje strategji per sport dhe tu japim hapsire te gjithëve per përkrahje.

Florim Mataj-thot se nëse nuk e bëjmë nje konision ashtu si propozoj drejtori i buxhetit ne nuk mund ta mbajmë as nje klub prandaj kërkoj ka thene ai qe te behet komisioni dhe te gjejmë nje modalitet si do ti mbajmë klubet..
Shkelzen Hadergjonaj-drejtori tha se i kemi 10.000 €, propozoj qe këto 10,000 € ti ndahen KF Deçani dhe klubit te hendbollit, përsëri mendoj qe Deçani duhet te përfaqësohet me nje klub te futbollit i cili do te behet ma cilsorë.
Fekri Qufaj-thot se kto 10.000 € jan vetëm si ndihme sepse jan shum pak per te gjitha klubet por duhet ta gjejmë nje zgjidhje.
Kryesuesi- thot te formohet komisioni ashtu si tha drejtori kurse per momemntin te perkrahet KF Deçani qe ti fillon garat nje here.
Perfaqsuesi i KF Besa- ka kërkuar qe te perkrahen edhe ata si klub dhe mos te anashkalohen krejte nga KF Deçani, ne vazhdim ai ka kërkuar qe te merr zotim nga asambleja se do te perkrahen bile ma vone ne menyre qe te kenë mundësi ti fillojnë garat ne sezonin vjeshtor.
Natyra Kuçi-thot se në Deçan te gjitha klubet e sportit janë ne mjerim prandaj duhet te kërkohen mundësi per zhvillim te sportit, pajtohem me propozimin qe te formohet nje komision per hartimin e nje plani afatgjate per sport sepse te perkrahet vetëm nje klub i caktuar nuk eshte fer.
Albana Avdiu- ka rruge sa te dushe per përkrahje te sportit vetëm duhet me pase vullnet dhe ide, si psh nga bizneset mund te kërkojmë qe t'i përkrahin klubet e sportit.
Milazim Mushkolaj-kërkon qe te vjen drejtoresha e kulturës ne asamble dhe me na tregu se qka mendon me vepru me klubet e sportit.
Avni Rexha, zyrtar i sportit- thot se e di qe kemi pak mjete por per ti filluar garat , prej nesër na duhet me nise me pagu.
Kushtrim Loshaj-Thot se per momentin te perkrahet KF Deçani por ma vone duhet te perkrahen edhe KF Besa dhe Klubi i hendbollit femrat.
Rifat Stojkaj- thot te behet nje tryezë pune me kryetarin e komunës dhe perfaqsueist e grupeve parlamentare dhe te shiqojme te gjitha mundësitë qe i kemi.
Fatmir Kurmehaj- thot te perkrahet fillimisht KF Deçani ne menyre qe te kete mundësi per fillimin e garave e pastaj mos te lehen pas as klubet tjera.
Milazim Mushkolaj- thot se pajtohet qe te takohemi me kryetarin por pse e ka drejtoria emrin "per sport" prandaj sipas emrit ata duhet te angazhohen.
Mon Selmonaj- pasi qe KF Besa nuk ban gara kete sezone propozoj qe kto 10.000 € qe i kemi me i nda ne dy pjese per KF Deçani 8.000 € dhe KF Besa 2000 €, dhe kjo me mirëkuptimin e përfaqësuesve te KF Besa qe pranuan te perkrahen ma vone dhe krejt kjo ne menyre qe Besa te perkrahet ne shtator kur fillojnë garat.
Florim Mataj-propozon qe shuma e mjeteve per sport prej 10.000€ te rritet, e propozimi per përkrahje te klubeve te na vjen ne mbledhjen tjetër.
Rifat Stojkaj- kërkon qe sot te miratohet shuma prej 10.000 € per KF Deçani, pastaj te mblidhemi dhe te shofim sa dhe si mund ti përkrahim edhe klubet tjera.
Kryesuesi- e qiti ne votim propozimin qe 10.000 € te perkrahet KF Deçani e pastaj t'i shofim mundësitë financiare sa mund ti përkrahim edhe te gjitha klubet tjera.
Antarët e kuvendit me shumic voatsh e miratuan, rezultati i votimit 13 per, 8 kunder.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANE • DEÇANI MUNICIPALITY • Kuvendi • Skupština Opštine • Assembly

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.solemne
Deçan,dt.30.03.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen solemne të Asamblesë Komunale , me dt.30.03.2019.
Në mbledhje në orën 11:00 ishin prezent: anëtarë të asamblesë, Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës, ish Kryetarët e Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Hoxha i Deçanit, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

11:00 Marrja e Vendimit për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, z.John C.Boyd, Gjeneral brigade, Ushtria e SHBA.

12:00 Ceremonia solemne e ndarjes së titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, z.John C.Boyd, Gjeneral brigade, Ushtria e SHBA.

Ora 11:00 Kryesuesi e hapi mbledhjen e III-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 20 asambleist.
Kryesuesi- në vazhdim sqaron për arsyen e thirrjes së kësaj mbledhje dhe rëndësinë që ka për ne si Kosovë , Gjenerali që sot ne do ta shpallim qytetar nderi i Komunës së Deçanit, pastaj kërkoj nga të pranishmit që të shtojnë diqka që dëshirojnë në lidhje me temën.
Meqenëse nuk kishte diskutime, kryesuesi e qiti në votim propozimin e kryetarit për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, z.John C.Boyd, Gjeneral brigade, Ushtria e SHBA.
Antarët Kuvendit njëzëri muarën vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, z.John C.Boyd, Gjeneral brigade, Ushtria e SHBA.

Ora 12:00 Seanca solemne e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, z.John C.Boyd, Gjeneral brigade, Ushtria e SHBA, në të cilën marrin pjesë edhe:Gjenerali i cili do te merr titullin Qytetar Nderi, Kryeministri i Kosoves, Z.Ramush Haradinaj me stafin e tij, deputet, qytetar të shumtë të Komunës së Deçanit, mediat.
Fillimisht Hymni i dy shteteve.
Kryesuesi i kuvendit përshëndeti me radhe pjesëmarrësit pastaj njoftoj se sot Kevendi ka marre vendim per shpalljen qytetar nderi Gjenralin amerikan z.John C.Boyd, në vazhdim ai ka fole per kontributin e gjeneralit ne shtet ndërtimin e Koosves, pastaj fton gjeneralin qe solemnisht tia dorëzon vendimin.
Kryetari i Komunës solemnisht ia dorëzon titullin Qytetar Nderi, në vazhdim në fjalën e tij thot urime per titullin, mirënjohje për të gjithë stafin e KFOR-it Amerikan.Gjenerali i drejtohet me një fjalë rasti të pranishmëve.
Kryesiministri i Kosovës i është drejtuar pjesëmarrësve të takimit me një fjalë rasti.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.III
Deçan,dt.03.04.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e III-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.03.04.2019.
Në mbledhje ishin prezent: anëtarët e asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, OSBE, KFOR, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për financimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal në mes Komunës së Deçanit dhe Komunat:Pejë, Gjakovë dhe Junik.
3. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e III-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 25 asambleist (mungon Albesa Cacaj) .
Kryesuesi- e prezentoj rendin e punës të propozuar me ftesë.
Mon Selmonaj- ka kërkuar sqarim rreth vonesave të rendit të punës sepse materiali na ka ardhe sot ka thene ai.
Kryesuesi- ka thënë se kjo temë është trajtuar para se të bëhet ftesa për mbledhje, poashtu është trajtuar edhe në KPF bashkë me kryetarin e Komunës dhe aty je pajtuar kështu ti bashkë me anëtarët tjerë të KPF-së, sepse ka qenë koha e kufizuar për nxënie të afatit për aplikim të projekteve.
Drejtori i Urbanzimit- sqaron se kjo çështje është urgjent për aplikim per projekte në bashkëpunim me Komunën e Pejës ku ne jemi lider ndërsa komuna e Pejes janë partner kurse me Gjakoven dhe Junikun ata janë lider kurse ne jemi partner, mirëpo per projektin konkret me komunën e Pejes janë pajtuar dy kryetaret dhe afati per aplikim eshte deri me dt.10 te ketij muaji.
Rifat Stojkaj- pyet, vendimi qe do te merret a vlenë vetëm me komunën e Pejes apo vlene per tri komunat.
Drejtori i Urbanizmit- pergjigjet se vendimi merret per te triat por per momentin do te aplikojmë per projekt me komunën e Pejes ku ne jemi lider.
Fatmir Kurmehaj-thot se i patëm disa qrregullime ne nxënien e afatit por meqenëse kjo shkon ne te mire te qytetarit ne si grup e përkrahim dhe jemi per.
Kryesuesi e qiti ne votim rendin e punes te propozuar me ftesë, antarët e asamblesë e miratuan njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Mon Selmonaj- kërkon sqarim deri ku kane shkuar punët rreth kërkesës së 27 qytetarëve të fshatit Rastavic rreth projektit të autostradës e cila kalon nëpër pronat e tyre, per te cilën kryetari pate premtuar se do te mbahet nje takim i përbashkët Komuna me kompaninë projektuese dhe akterët tjerë qe përfshihen ne kete qeshtje, pastaj ai ka bere vërejtje se nuk i eshte perfshi e plotë fjala e tij te raporti i auditimit.
Drejtori Urbanizmit sqaron rreth qështjes së autostradës.

Kryesuesi- e qiti ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, antarët e kuvendit e miratojnë ate me nje vote kunder (Mon Selmonaj).

II. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për financimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal në mes Komunës së Deçanit dhe Komunat:Pejë, Gjakovë dhe Junik.

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj ka shtuar se rreth kësaj teme u debatua mjaft ne fillim te mbledhjes meqenëse kjo ka qene arsyeja e thirrjes se kësaj mbledhje, pastaj kërkoj nga asambleistet qe nëse ka dikush për të shtuar diqka qe nuk eshte debatuar me pare, meqenëse nuk kishte debat kryesuesi e qiti ne votim antaret e Kuvendit e miratuan ate njëzëri.

XI.Të ndryshme.

Kryesuesi- i prezenton dy kërkesa të klubeve sportive te cilat kanë ardhë ne kuvend nga KPF, 1.Kërkesa e KF "Besa" Irzniq dhe 2.KH "jusf Gërvalla" Deçan, femrat.

Rifat Stojkaj- thot se me kete teme jemi marre mjaft ne mbledhjet e kaluara prandaj mendoj se eshte e udhës me i perkrahe këto dy klube.

Florim Mataj- thot se jemi per perkraje te dy klubeve.

Fatmir Kurmehaj- thot se per klubin Besa jemi pajtu qe mjetet ti qiten ma vone kurse klubi i hendbollit tash.

Milazim Mushkolaj- kërkon sqarim nga drejtoresha e Drejtorisë per Kulturë, Rini dhe Sporte rreth angazhimit dhe përkrahjes se drejtoris per klubet e sportit, meqenëse sporti hyn ne kuadër te kësaj drejtorie, sqarimi per mbledhjen e radhës.

Kryesuesi- e qiti ne votim kërkesën e KF "Besa "Irzniq në shumën prej **6,350.00 €**, mjete te cilat do te akzekutohen para fillimit te pergaditjeve per sezonin vjeshtor dhe , 2.Kërkesën e Klubit të Hendbollit "Jusuf Gërvalla"- Deçan Femrat, **në shumën prej 7,375.00 €.**

Antarët e kuvendit i miratuan dy kërkesat e klubeve sportive njëzëri, ekzekutimi i Mjeteve financiare per klubin e hendbollit duhet te behet menjëherë kurse per klubin e futbollit para fillimit te sezonit vjeshtor.

Agnesa Vokshi- ka kërkuar sqarim kure do te fillojnë punimet e rrugëve ne fshatin Pobergjë.

Drejtori Urbanizmit sqaron se rrugët e fshatit Pobergjë janë në kuadër te projekteve që hyjnë në njërën nga dy llotet e rrugëve dhe tani jemi ne pergaditje te fillimit te punimeve.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • KOMUNA E DEÇANIT • KUVENDI • KOMUNA DEÇANE • OPŠTINA DEČANE • DEÇANI MUNICIPALITY • Komunal Assembly • Kuvendi • Kuvendi i Komunës

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj